



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr. 537/15

GJYKATA THEMELORE PEJË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM sipas gjyqtares, Nushe Kuka Mekaj-gjyqtare, me sekretaren juridike Fitore Bojku, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit M.T, nga P, për shkak të veprës penale vjedhje pylli, nga neni 358 par.2, të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/Il.nr.974/15, të dt.07.07.2015, në seancën e shqyrtimit gjyqësor publik, të mbajtur dhe të përfunduar me dt. 18.04.2017, në prezencën e prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarit M.T, në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.19.4.2017, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

M.T, i biri i H, i nënës Z, e gjinisë G, i lindur me dt...., në fsh. J e M, K. P, ku edhe tani jeton, identifikohet në bazë të Inj.nr. 1....., të lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, babë i 7 fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

Në kuptim të nenit 363 par.1, pika 1.1, të KPP-së.

REFUZOHET AKTAKUZA

Për shkak se:

Me dt. 27.04.2015, rreth orës 09:35, në pyllin kombëtar, në vendin e quajtur “P K”, rajoni ekonomik pyjor “Zhleb”, i cili administrohet nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, zyra në Pejë, i pandehuri me qëllim të vjedhjes, ka prerë 50 copë trungje të llojit të ahut me diametër prej 07-10 m, e me vëllim të përgjithshëm prej 0.50 m3, me ç’rast Drejtoratit në fjalë i ka shkaktuar dëme materiale.

- me çka kishte për të kryer vepër penale vjedhje pylli, nga neni 358 par.2, lidhur me par.1, të KP-së,

Për shkak të heqjes dorë të prokurores së shtetit nga ndjekja penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Përf. i aut. i të dëmtuarës DAPK-Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm në Pejë ka ngrit aktakuzë. PP/II.nr.974/15, të dt.07.07.2015, M.T, për shkak të veprës penale vjedhje pylli, nga neni 358 par.2, të KP-së, ku prokurorja e shtetit ka bërë përmirësimin e cilësimit juridik, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, pas dëgjimit të dëshmitarit B.H dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës bazuar në dispozitat ligjore të po këtij neni, sipas ri cilësimit juridik rezultoi se për të ekzistuar kjo vepër penale si kusht bazë duhet të jetë prerë sasia e drunjtëve mbi 2 m³, e që në rastin konkret kemi sasinë prej 0.50 m³, andaj në veprimet e të pandehurit M.T nuk janë realizuar elementet e veprës penale nga neni 358 par.2, lidhur me par.1 të KP-së.

Meqenëse prokurorja e shtetit është tërheq nga ndjekja penale për të akuzuarin M.T, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 363 par.1, pika 1.1, të KP-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454, e lidhur me nenin 450 par.2 nën par. 2.1 deri 2.5, të KPP-së.

Vendimi me të cilin pala e dëmtuar është udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil, është bazuar në nenin 463 par.3 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, P.nr.537/15.

Sekretarja Juridike,
Fitore Bojku

Gjyqtarja e vetme gjyqësore,
Nushe Kuka Mekaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas Marrjes së të njëjtës, Gjykatës së Apelit Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate .